

# 5 fazat

## ndryshimi i qëndrimeve

NJË BURIM I ELIM CHRISTIAN SERVICES  
TRANSLATION BY MARION

FAZA E PESTË: **BASHKËPUNËTORË**

FAZA E KATËRT: **MIQËSIA**

Në qoftë se Perëndia e ka thirrur secilin prej nesh që ti shërbejë dhe ti lutet Atij me çdo qelizë të qënieve tona, atëherë ai e ka bërë të njëjtën gjë nëpërmjet Krishtit për vëllezërit dhe motrat tona me aftësi të kufizuara. Unë mendoj se shërbesa nuk duhet të jetë vetëm për njerëzit me aftësi të kufizuara por me ose përreth njerëzve që kanë aftësi të kufizuara. Së bashku, ne do të inkurajojmë dhe sigurojmë njëri-tjetrin, me dhe pa aftësi të kufizuara, në çdo vepër të mirë për t'iu përgjigjur thirrjes së Perëndisë në jetët tona. Ne të gjithë mund të japim dhe të gjithë mund të marrim.

FAZA E TRETË: **PËRKUJDESJA**

Unë kam ardhur të njoh dhe të kaloj kohë me një mik i cili është me aftësi të kufizuara. Ky person ka vlerë jo vetëm në sytë e Perëndisë, por gjithashtu në sytë e mi dhe e di që jeta ime është bërë më e mirë që kur e njoha këtë person dhe sa më shumë që e kam ndihmuar atë, aq edhe ajo më ka bekuar mua. Në fakt, unë tani dua të krijoj marrëdhënie me njerëz me aftësi të kufizuara. Perëndia sjell shumë njerëz të ndryshëm në Kishën dhe komunitetin tim, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe ne të gjithë përfitojmë teksa miqësohemi me njëri – tjetrin.

FAZA E DYTË: **MËSHIRA**

Edhe njerëzit me aftësi të kufizuara, ashtu si unë janë krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Por duke u nisur vetëm nga ai fakt, ata kanë vlerë. Unë shpresoj që dikush të gjejë kohën t'ju tregojë atyre dashurinë e Perëndisë, dhe unë do ta mbështesja i lumtur një përpjekje të tillë. Në fakt, unë mendoj se duhet të gjejmë mënyra për ti ndihmuar ata njerëz. Ndoshta ne duhet të hapim një klasë mësimore të veçantë të kishës ose të tregojmë kujdes për shkak të prindërve.

Më vjen keq për njerëzit me aftësi të kufizuara. Është me të vërtetë shumë e keqe. Unë jam i bekuar nga Perëndia dhe mund të ndihmoj të tjerët. Jam mirënjohës që fëmijët e mi nuk janë me aftësi të kufizuara. Padyshim, njerëzit me dobësi dhe me aftësi të kufizuara kanë nevojë për dikë si unë që ti ndihmojë ata dhe t'u japë atyre kuptim pavarësisht problemeve që kanë. Me të vërtetë unë nuk shoh ndonjë kuptim apo qëllim në jetën e tyre.

FAZA E PARË: **PADITURIA**

Dobësia dhe paaftësitë janë një shenjë që Perëndisë as nuk i intereson dhe as nuk është në gjendje ta rregullojë situatën. Në fakt, ato mund të jenë rezultat i mëkatit apo i mungesës së besimit. Perëndia nuk është i përfshirë në jetën e dikujt me aftësi të kufizuara, sepse Ai nuk mund të përdorë njerëz të cilët janë caq të thyer. Unë nuk njoh njerëz me aftësi të kufizuara, e as nuk di asgjë për aftësitë e kufizuara. Unë nuk kam asnjë interes ti njoh ata apo të di më shumë për jetën e tyre.

NDËRGJEGJËSIMI

QASJA E SIGURUAR

INTEGRIMI

ANGAZHIMI



VISIT THE WHEATON CENTER FOR FAITH AND DISABILITY FOR MORE INFORMATION AND RESOURCES.



**Elim**

"5 STAGES: CHANGING ATTITUDES" IS COPYRIGHT © 2009, DAN VANDER PLAATS, WITH THANKS TO ELIM CHRISTIAN SERVICES, DISABILITY CONCERNS CRC AND RCA, ENGAGING DISABILITY, JONI AND FRIENDS, AND WHEATON COLLEGE